



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.558/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.08.2019 shqyrtoi ankesat me:

Objekt:

“Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Nazeri 200” shpk nga procedura e prokurimit “Shërbimi i Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike me roje private” – Marrëveshje Kuadër-me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara- me afat 12 muaj, me Nr. REF-24397-05-29-2019, me fond limit 2.333.333,3 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datën 10.06.2019 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Shëndetit Publik Mat”.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Snajper Security” shpk në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorëve ekonomikë “Grand Security” shpk, “Safe” shpk, “Res-03” shpk dhe “Trezhnjeva” shpk në këtë procedurë prokurimi”.

“Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Safe” shpk nga procedura e prokurimit objekt ankimi”.

Ankimues:

“Nazeri 2000” shpk
Adresa: Rruga “Kavajës”, Qendra Condor, kati II, Tiranë.

“Safe” shpk
Rr. “Bernard Bitola”, kulla “Haëai-Tower”, nr. 17, kati I, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Shëndetit Publik Mat
Lgj. “Drita”, rrg. “Ibrahim Temo” Burrel

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2 Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 30.05.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Shërbimi i Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike me roje private” – Marrëveshje Kuadër- me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara- me afat 12 muaj, me Nr. REF-24397-05-29-2019, me fond limit 2.333.333,3 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datën 10.06.2019 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Shëndetit Publik Mat”.

II.2. Në datën 17.06.2019 operatorët ekonomikë pjesëmarrës, janë njoftuar elektronikisht nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi klasifikimin e ofertave gjatë procesit të vlerësimit, si dhe ofertuesit e skualifikuar si vijon:

"SNAJPER SECURITY" shpk	2.253.599,40 lekë	Kualifikuar
"SAFE" shpk	2.253.599,40 lekë	Skualifikuar
“GRAND SECURITY” shpk	2.253.599,40 lekë	Skualifikuar
“NAZERI- 2000” shpk	2.253.599,40 lekë	Skualifikuar
“RES-03” shpk	2.253.599,40 lekë	Skualifikuar
“TREZHNJEVA” shpk	2.253.599,40 lekë	Skualifikuar

II.3. Në datën 17.06.2019 operatori ekonomik “Nazeri 2000” shpk, është njoftuar elektronikisht nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi skualifikimin e ofertës për arsye se:

*“ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “NAZERI 2000” Sh.p.k, për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret Përgjithshme e të Veçanta të Pranimi/ Kualifikimit, si më poshtë: I. Nuk është përmbushur përcaktimi i gërmës “c” Kapaciteti teknik:/ pika 4 ku përcaktohet: CV të shoqërisë dhe stafit kryesorë përgjegjës për zbatimin e kontratës. - Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës, nuk është paraqitur CV e stafit kryesor, përkatësisht të titullarit të subjektit. II. Nuk është përmbushur përcaktimi i gërmës “c” Kapaciteti teknik:/ pika 5/2 ku përcaktohet: Të gjitha mjetet speciale të jenë të vërtetuara me anë të faturave tatimore dhe likuidimin bankar përkatës. - Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës, pasi “Formulari i Aplikimit për transfertë individuale” për blerjen e mjeteve speciale (Pranga Lidhëse dhe Shkopinj Gome) nuk është paraqitur origjinal, ose kopje e noterizuar. *(Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.) Për këto arsye në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 53 pika 3, neni 55 pika 2 të tij, si dhe Vendimit i Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” nenit 28, 66 të tij, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) unanimisht vendosi të s’kualifikojë Operatorin Ekonomik*

pjesëmarrës, shoqëria: "NAZERI 2000" Sh.p.k, pasi nuk përmbush kushtet dhe kërkesat e paraqitura në njoftimin e kontratës."

II.3.1. Në datën 21.06.2019 operatori ekonomik "Nazeri 2000" shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij, gjithashtu dhe kualifikimin e operatorit ekonomik "Snajper Security" shpk, si dhe kërkon shtimin e arsyeve të skualifikimit të operatorëve ekonomikë "Grand Security" shpk, "Safe" shpk, "Res-03" shpk dhe "Trezhnjeva" shpk në këtë procedurë prokurimi. Konkretisht pretendohet si vijon:

*"Shoqeria jone eshte skualifikuar me pretendimin se " Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria "NAZERI 2000" Sh.p.k, për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret Përgjithshme e të Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë: I. Nuk është përmbushur përcaktimi i gërmës "c" Kapaciteti teknik:/ pika 4 ku përcaktohet: CV të shoqërisë dhe stafit kryesorë përgjegjës për zbatimin e kontratës. - Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës, nuk është paraqitur CV e stafit kryesor, përkatësisht të titullarit të subjektit. II. Nuk është përmbushur përcaktimi i gërmës "c" Kapaciteti teknik:/ pika 5/2 ku përcaktohet: Të gjitha mjetet speciale të jenë të vërtetuara me anë të faturave tatimore dhe likuidimin bankar përkatës. - Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës, pasi "Formulari i Aplikimit për transfertë individuale" për blerjen e mjeteve speciale (Pranga Lidhëse dhe Shkopinj Gome) nuk është paraqitur origjinal, ose kopje e noterizuar. *(Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.) Për këto arsye në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik" (i ndryshuar), neni 53 pika 3, neni 55 pika 2 të tij, si dhe Vendimit i Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" neni 28, 66 të tij, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) unanimisht vendosi të s'kualifikojë Operatorin Ekonomik pjesëmarrës, shoqëria: "NAZERI 2000" Sh.p.k, pasi nuk përmbush kushtet dhe kërkesat e paraqitura në njoftimin e kontratës."*

I. Se pari, autoriteti duhet te kualifikoje shoqerine tone pasi arsyeja e skualifikimit "Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur nga Operatori Ekonomik , shoqeria "NAZERI 2000 " Sh.p.k, per pjesemarrje ne tender, rezulton se nuk permbush te gjithe dokumentacionin e kerkuar ne perputhje me Kriteret Pergjithshme e te Vecanta te Pranimit/ Kualifikimit , si me poshte : I Nuk eshte permbushur percaktimi i germes "c " Kapaciteti teknik:/ pika 4 ku percaktohet: CV te shoqerise dhe stafit kryesore pergjegjes per zbatimin e kontrates. - Ky kusht nuk permbushet nga ana e operatorit ekonomik pjesemarres , nuk eshte paraqitur CV e stafit kryesor, perkatesisht te titullarit te subjektit " nuk qendron dhe eshte e pabazuar pasi:

-Ne dst "c" Kapaciteti teknik:/ pika 4 eshte kerkuar: "CV te shoqerise dhe stafit kryesore pergjegjes per zbatimin e kontrates "

-Ne permbushje te kerkeses se dhene ne dst nga ana jone ne dokumentin me emertim "I3_CV_shoqerie_NAZERI" jane paraqitur:

-CV te sh.p.s.f. "nazeri 2000" drejtuesi teknik dhe personelit

- CV te drejtuesi teknik
- Curriculum I Stafit Drejtues Te Shoqerise
- Curriculum Vitae Te Staf Nazeri 2000

Pra ne permbushje te kerkeses se dhene ne dst, per aq sa AK eshte shprehur dhe ka kerkuar nga ana jone jane paraqitur CV te shoqerise, stafit drejtues dhe stafit kryesor pergjegjes per zbatimin e kontrates. Pra arsyeja e skualifikimit nuk qendron.

Per me teper pretendimi i AK se "nuk eshte paraqitur CV e stajit kryesor, perkatesisht te titullarit te subjektit" nuk qendron pasi ne asnje pike ne dst nuk eshte kerkuar cv per titullar te subjektit dhe nga ana e AK nuk mund te skualifikohemi mbi bazen e kriterëve te pashprehuara ne menyre te qarte ne dst.

Qendrim te ngjashem mban edhe KPP ne vendimin nr. 113/2019, date 01.03.2019, ku shprehet: "Referuar kriterit te kualifikimit nuk rezulton qe autoriteti kontraktor te kete kerkuar qe vertetimi i performances te jete me ndonje lloj vleresimi pozitiv per veprimtarine e shoqerise por ne kriter eshte kerkuar shprehimisht qe operatorët ekonomike te mos kene gjoba administrative apo procedim penal per shkelje te rregullave te sherbimit gjate aktivitetit te tij si Shpsf, vertetim ky i leshuar brenda 6 muajve te fundit. Sa me siper, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se Autoriteti kontraktor ne vleresimin e ofertave nuk mund te perdore asnje kriter i cili nuk eshte i perfshire ne dokumentat e tenderit ne kuptim te nenit 55 "Kriteret e Percaktimit te Ofertes Fituese" pika 2 e LPP i cili parashikon shprehimisht se: Autoriteti kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme, per te percaktuar oferten fituese, ne perputhje me procedural dhe kriteret e percaktuara ne dokumentet e tenderit. Nuk duhet te perdoret asnje kriter, qe nuk eshte perfshire ne dokumentet e tenderit.

Per sa me siper AK duhet te kualifikoje shoqerine tone pasi arsyeja e skualifikimit nuk qendron.

Si dhe autoriteti duhet te kualifikoje shoqerine tone pasi arsyeja e skualifikimit "II. Nuk eshte permbushur percaktimi i gemes "c" Kapaciteti teknik:/ pika 5/2 ku percaktohet: Te gjitha mjetet speciale te jene te vertetuara me one te faturave tatimore dhe likujdimin bankar perkates.

- Ky kusht nuk permbushet nga ana e operatorit ekonomik pjesemarres, pasi "Formulari i Aplikimit per transferte individuale" per blerjen e mjeteve speciale (Pranga Lidhese dhe Shkopinj Gome) nuk eshte paraqitur origjinal, ose kopje e noterizuar. *{Te gjithe dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre. Rastet e mos-dorezimit te nje dokumenti ose te dokumentave te rreme e te pasakta , konsiderohen si kushte per skualifikim, nuk qendron dhe eshte e pa bazuar pasi:

-Ne dst "c" Kapaciteti teknik:/ pika 5 eshte kerkuar: " 5.Subjekti SHPSF duhet te paraqese vertetim dhe performance nga Drejtoria Vendore e Policise e Qarkut Diber ne baze te ligjit 7512014 "Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike" I.3 A, te leshuar jo me pare se tre muaj nga dita e hapjes se ofertave nepermjet te cilit te jepet informacion mbi: •Pranga Lidhese cope 3 (tre). •Shkopinj Gome cope 3 (tre). Te gjitha mjetet speciale te jene te vertetuara me ane te faturave tatimore dhe likujdimin bankar perkates ".

-Ne permbushje te kerkeses se dhene ne dst nga ana jone ne dokumentat e tenderit kemi paraqitur:

- Vertetim dhe performance nga Drejtoria Vendore e Policise se Qarkut Diber nr.104 date 09.04.2019 ku shprehet dhe vertetohet se Shoqeria Nazeri 2000 ka hekura lidhes (pranga) dhjete cope dhe shkop gome dhjete cope duke permbushur dhe tejkualuar disa here numrin e kerkuar nga AK ne dst prej vSafe3 cope.

- Gjithashtu ne dokumentin me emertim "16 Fatura Dedektor Sistem Alarmi Sistem Kamera Gps Dvr Radio Nazeri", ku kemi paraqitur fatura tatimore per te gjitha mjetet speciale te kerkuara ne dst perfshire pranga lidhese shkopinj gome se bashku me likujdimet e kryera nga ana jane dhe per kete arsye pretendimi i Ak nuk qendron. Gjithashtu sqarojme AK se pagesat kryhen elektronikisht dhe formularet jane elektronike dhe shkarkohen direkt nga sistemi .

Per autoritetin kontraktor eshte e nevojshme dhe e mjaftueshme qe operoret ekonomike te plotesojne te gjitha kapacitetet ekonomike, teknike, profesionale per realizimin me sukses te kontrates dhe kerkesa e dhene nga Ak eshte permbushur plotesisht nga ana jane e vertetuar edhe nepermjet vertetimit te policise. I sqarojme Ak se referuar edhe nje vendimi te KPP nr. 155/2017 date 21.03.2017 per analogji shprehet se "Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se duke qene se pajisjet ne fjale jane pajisje ndihmese ne funksion te kryerjes me sukses te sherbimit te percaktuar ne kontraten objekt prokurimi , eshte e mjaftueshme qe operatori ekonomik te tregoje se disponon pajisjet/mjetet ne fjale ne menyre opsionale ose nepermjet Vertetimit leshuar nga Drejtoria e Policise se Qarkut Elbasan ose nepermjet paraqitjes se fatures tatimore per blerjen e tyre. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet te marre masa per modifikimin e kriterit ne fjale". Si dhe ne vendi min nr. 300/2019 date 21.05 .2019 ku shprehet se : "Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se duke qene se pajisjet ne fjale , sic u trajtuar ne piken "III. 7. 7" dhe "III. 7.8 ", jane pajisje ndihmese ne funksion te kryerjes me sukses te sherbimit te percaktuar ne kontraten objekt eshte e mjaftueshme qe operatori ekonomik te tregoje se disponon pajisjet/mjetet ne fjale ne menyre opsionale ose nepermjet Vertetimit leshuar nga Drejtoria e Policise se Qarkut ose nepermjet paraqitjes se fatures tatimore per blerjen e tyre".

Qendrim te njejte mban edhe KPP ne vendimin nr. 353/2018 date 25.05.2018 ku shprehet se "Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se eshte detyre e operatoreve ekonomike te permbushin detyrimet qe rrjedhin nga kuadri ligjor ne fuqi (ne rastin konkret detyrimet tatimore) vSafene peputhje me kerkesat e ketij te fundit. Pra, permes dokumentacionit te dorezuar ne S.P.E palet ankimuese kane permbushur kerkesen e autoritetit kontraktor ".

Pra kerkesa per mjete speciale e dhene ne dst eshte permbushur plotesisht dhe tejkualuar nga ana jone dhe per kete arsye arsyeja e skualifikimit nuk qendron.

Per sa me siper AK duhet te kualifikoje sboqerine tone pasi arsyeja e skualifikimit nuk qendron pasi kemi permbushur te gjitha kerkesatg e dhena ne dst .

2. Se dyti, nga ana e Ak duhet te skualfikohet shoqeria Sh.P.S.F "Snajper Security" dhe te shtohen arsye skualifikimi per "Grand Security" shpk, "Safe" shpk, "Res-03" shpk, "Trezhnjeva" shpk pasi nuk kane paraqitur preventivin per vendroje sipas shtojces 1 si dhe analizen e kosos per vendroje sipas kerkeses se dhene ne dst "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" pika 3, dhe nuk kane ofertuar

sipas formatit te tabelës se dhënë per formularin e ofertës duke mos permbushur kështu kërkesën sipas dës dës qarimit te AK.

3. Se treti, nga ana e Ak duhet te skualifikohet shoqëria Sh.P.S.F "Snajper Security" dhe te shtohen arsye skualifikimi per "Grand Security" shpk, "Safe" shpk, "Res-03" shpk, "Trezhnjeva" shpk pasi nuk kanë plotësuar kërkesën e dhënë ne dës "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" pika 2, pasi nuk kanë dorëzuar raportin e auditimit per pasqyrat financiare te tre viteve. Te njëjtin qëndrim mban edhe KPP me vendime te ngjashme nr. 290/2019 date 17.05.2019 ku shprehet se: "Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorëzuar nga shoqëria "Safe " shpk nuk rezulton te jete dorëzuar raporti i auditimit per pasqyrat financiare te viteve 2016, 2017 dhe 2018, ndërsa nga dokumentacioni I dorëzuar nga shoqëria " International Security Albania" shpk rezulton se nuk është dorëzuar raporti i auditimit per pasqyrën financiare te vitit 2018, sikurse parashikohet ne legjislacionin ne fuqi te siperpermendur . Ne keto kushte KPP gjykon se keta operatore ekonomike nuk kanë zbatuar detyrimin ligjor per auditimin e pasqyrave financiare".

4. Se katërti, nga ana e Ak duhet te skualifikohet shoqëria Sh.P.S.F "Snajper Security" dhe te shtohen arsye skualifikimi per "Grand Security" shpk, "Safe" shpk, "Res-03" shpk, "Trezhnjeva" shpk pasi nuk kanë plotësuar kërkesën e dhënë ne dës Kapaciteti teknik pika 8/iii pasi nuk kanë paraqitur dokumentin leje drejtimi te vlefshme per mjetin dhe nuk kanë dokumentacion te vlefshme te mjetit, siguracion, kolaudim taksa duke mos permbushur kërkesën ne dës.

5. Se pesti, nga ana e Ak duhet te skualifikohet shoqëria Sh.P.S.F "Snajper Security" dhe te shtohen arsye skualifikimi per "Grand Security" shpk, "Safe" shpk, "Res-03" shpk, "Trezhnjeva" shpk pasi nuk kanë plotësuar kërkesën e dhënë ne dës kapaciteti teknik pika 3 pasi nuk kanë paraqitur AKEP sistem radio alarmi me zone mbulimi qyteti Burrel te vlefshem sipas kërkesës ne dës .

6. Se gjashti, nga ana e Ak duhet te skualifikohet shoqëria Sh.P.S.F "Snajper Security" dhe teshtohen arsye skualifikimi per "Grand Security" shpk, "Safe" shpk, "Res-03" shpk, "Trezhnjeva" shpk pasi nuk permbushin kërkesën e dhënë nga Ak ne dës per numrin e punonjesve te grupit te gatshem dhe operatorve sipas percaktimeve ligjore.

Perfundimisht nga Argumentimi i bere sa me siper kerkojme nga ana e Autoritetit te behet kualifikimi I shoqërise sone pasi arsyeja e skualifikimit nuk qëndron, pra skualifikimi është here ne menyre te njëanshme dhe te padrejte. Si dhe nga ana e Ak te skualifikohet shoqëria Sh.P.S.F "Snajper Security" dhe te shtohen arsye skualifikimi per "Grand Security" shpk, "Safe" shpk, "Res-03" shpk, "Trezhnjeva" shpk pasi nuk plotësojne kërkesat ne dës".

II.3.2. Referuar ankesës së operatorit ekonomik "Nazeri 2000" shpk dhe dokumentave bashkëlidhur, rezulton se me anë të shkresës nr.prot.289 prot, date 27.06.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje shoqërisë "Nazeri 2000" shpk, ku ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.3.3. Në datën 02.07.2019, pala ankimuese "Nazeri 2000" shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtuar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

III.4. Në datën 17.06.2019, operatori ekonomik “Safe” shpk është njoftuar elektronikisht nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi skualifikimin e ofertës për arsye se:

“Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “SAFE” Sh.p.k, për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret Përgjithshme e të Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë: I. Nuk është përmbushur përcaktimi i gërmës “c” Kapaciteti teknik:/ pika 1 ku përcaktohet: “Ofertuesi duhet të paraqesë kontrata shërbimi të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit, të kryera gjate tre viteve të fundit (2016, 2017, 2018) në një vlerë prej 30% e fondit limit. Këto shërbime të së njëjtës natyrë do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:... Ose - Kur përvoja e ngjashme është realizuar me subjekte private, Op. Ek. do ta vërtetojë këtë kërkesë duke paraqitur faturat tatimore të shitjes, ku të shënohet datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. - Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës, pasi Faturat Tatimore Shitje të paraqitura për shërbimin e kërkuar nuk përmbajnë të gjitha elementët e faturës (vulën e shitësit të shërbimit) në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi për faturën tatimore shitje të miratuar. II. Nuk është përmbushur përcaktimi i gërmës “c” Kapaciteti teknik:/ pika 5 ku përcaktohet: “Subjekti SHPSF duhet të paraqesë vërtetim dhe performance nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Dibër në bazë të ligjit 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" 1.3 A, të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertave nëpërmjet të cilit të jepet informacion mbi: ... • Të mos ketë ngjarje dhe masa administrative gjatë vitit të fundit (2018). - Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës, pasi në Vërtetimin e paraqitur nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Dibër, nuk jepet informacion që operatori ekonomik të mos ketë patur ngjarje dhe marrë masa administrative gjatë vitit të fundit (2018) III. Nuk është përmbushur përcaktimi i gërmës “c” Kapaciteti teknik:/ pika 6 ku përcaktohet: Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) armë brezi, kategoria 1.3 A vërtetuar me: - Autorizim për blerje armësh lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, - Kontratë Shitblerje, - Fatura Shitblerje dhe - Pagesën Bankare - Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës, pasi mungonte pagesa bankare (Mandati bankar) për Faturën e paraqitur të blerjes së armës. Për këto arsye në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 53 pika 3, neni 55 pika 2 të tij, si dhe Vendimit i Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” neni 28, 66 të tij, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) unanimisht vendosi të s’kualifikojë Operatorin Ekonomik pjesëmarrës, shoqëria: “SAFE” Sh.p.k, pasi nuk përmbush kushtet dhe kërkesat e paraqitura në njoftimin e kontratës”.

II.4.1. Në datën 19.06.2019 operatori ekonomik “Safe” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin tij. Konkretisht pretendohet si vijon:

“Sh.p.s.f SAFE sh.p.k mori dijeni ne faqen zyrtare te Agjencise te Prokurimit Publik ëëë.app.gov.al me njoftimin e renditjes se operatoreve ekonomike pjesemarres ne proceduren e prokurimit publik me objekt “Sherbimi i Ruajtjes dhe Sigurise Fizike me roje private” ,e organizuar nga Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Shendetit Publik Mat zhvilluar ne date 10.06.2019.

Nisur nga vleresimi I operatoreve ekonomike pjesemarrës në këtë procedurë në kundërshtim me rregullat e miratuara të prokurimit publik, në zbatim të nenit 63 i LPP 11Te drejtat e personit të interesuar", në datën 19.06.2019 ju drejtojmë këtë ankese si vijon:

- a. *KVO-ja e ngritur nga A.K Drejtoria e Shëndetit Publik Mat për vlerësimin e operatoreve në këtë procedurë ka publikuar në dt 17.06.2019 në faqen qeveritare www.app.gov.al ,si argumenta për skualifikimin e shoqërisë Safe si më poshtë vijon:*

“Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “SAFE” Sh.p.k, për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret Përgjithshme e të Veçanta të Pranimi/ Kualifikimit, si më poshtë: I. Nuk është përmbushur përcaktimi i gërmës “c” Kapaciteti teknik:/ pika 1 ku përcaktohet: “Ofertuesi duhet të paraqesë kontrata shërbimi të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tre viteve të fundit (2016, 2017, 2018) në një vlerë prej 30% e fondit limit. Këto shërbime të së njëjtës natyrë do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:... Ose - Kur përvoja e ngjashme është realizuar me subjekte private, Op. Ek. do ta vërtetojë këtë kërkesë duke paraqitur faturat tatimore të shitjes, ku të shënohet datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. - Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës, pasi Faturat Tatimore Shitje të paraqitura për shërbimin e kërkuar nuk përmbajnë të gjitha elementët e faturës (vulën e shitësit të shërbimit) në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi për faturën tatimore shitje të miratuar. II. Nuk është përmbushur përcaktimi i gërmës “c” Kapaciteti teknik:/ pika 5 ku përcaktohet: “Subjekti SHPSF duhet të paraqesë vërtetim dhe performance nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Dibër në bazë të ligjit 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" 1.3 A, të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertave nëpërmjet të cilit të jepet informacion mbi: ... • Të mos ketë ngjarje dhe masa administrative gjatë vitit të fundit (2018). - Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës, pasi në vërtetimin e paraqitur nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Dibër, nuk jepet informacion që operatori ekonomik të mos ketë patur ngjarje dhe marrë masa administrative gjatë vitit të fundit (2018) III. Nuk është përmbushur përcaktimi i gërmës “c” Kapaciteti teknik:/ pika 6 ku përcaktohet: Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) armë brezi, kategoria 1.3 A vërtetuar me: - Autorizim për blerje armësh lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, - Kontratë Shitblerje, - Fatura Shitblerje dhe - Pagesën Bankare - Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës, pasi mungonte pagesa bankare (Mandati bankar) për Faturën e paraqitur të blerjes së armës. Për këto arsye në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 53 pika 3, neni 55 pika 2 të tij, si dhe Vendimit i Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” neni 28, 66 të tij, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) unanimisht vendosi të s’kualifikojë Operatorin Ekonomik pjesëmarrës, shoqëria: “SAFE” Sh.p.k, pasi nuk përmbush kushtet dhe kërkesat e paraqitura në njoftimin e kontratës”.

Se pari për sa i përket arsye se pare të skualifikimit se nuk kemi paraqitur faturat tatimore të shitjes, sqarojmë se në folderin me nominativin "Kontrate shërbimi 2016 fature reference" kemi

dorezuar elektronikisht jo vSafefaturat tatimore me vlere qe tejkalojne me 10 here vleren e kontrates qe prokurohet por edhe Leter referencen e dates 24.03.2017 leshuar nga Drejtori I Sigurise se Bankes Credins ne te cilen eshte e shkruajtur ne menyre eksplicite se shoqeria jone e ka realizuar me se miri kontraten ne fjale te ciles I referohen edhe faturat tatimore te shitjes ndaj gjykojme se ky argument eshte jo vSafeeshte I pabazuar por eshte jo ligjor dhe diskriminues.

Per sa me siper ne zbatim te dispozitave te Ligjit 9643 "Per prokurimin publik" I ndryshuar, perkatesisht nenet 1 ,2 ,46/1 dhe 55/2 I kerkojme A.K te korrigoje shkeljen e KVO-se duke kualifikuar operatorin "Safe" sh.p.k.

Se dyti per sa I perket arsye se dyte te skualifikimit se nuk kemi paraqitur mandatin bankar per blerjen e armeve te shkrutra, sqarojme A.K se ne folderin me nominativin "diber AUTORIZIM blerje mbajtje armesh" kemi dorezuar elektronikisht dokumentacionin e plate si autorizimet e Drejtorise Policise se Shtetit te firmosura nga Drejtori I Policise se Shtetit, kontratat e blerjeve te armeve, balistikat e armeve, faturat tatimore te shitjes, mandatet bankare 6 (gjashte) cope si dhe autorizime per mbajtje armesh individuale. Pra te gjithë dokumentacion ligjor te percaktuar nga Ligji 74/2014 I "Per armet" si dhe Ligji nr 75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike",ku mbi te gjitha numri armeve e tejkalon me disa here kriterin e kerkuar nga A.K.

Argumenti I KVO-se eshte totalisht absurd dhe I pabazuar ne fakte konkrete per sa kohe qe dokumentacioni jo vSafeqe eshte dorezuar por eshte lehtesisht I verifikueshem ne ëëë.app.gov.al, gjithsesi theksojme se shoqeria jane ka permbushur kriteret e vendosura ne DST pergjegjesia per vleresimin me dy standarte referuar dokumentacionit dhe fakteve I ngelet zyrtareve te KVO-se.

Per sa me siper ne zbatim te dispozitave te Ligjit 9643 "Per prokurimin publik" I ndryshuar, perkatesisht nenet 1 ,2 ,46/1 dhe 55/2 I kerkojme A.K te korrigoje shkeljen e KVO-se duke kualifikuar operatorin "Safe" sh.p.k.

Per sa me siper ne zbatim te dispozitave te Ligjit 9643 "Per prokurimin publik" I ndryshuar ,perkatesisht nenet 1 ,2 ,46/1 dhe 55/2 I kerkojme K.P.P te urdheroje A.K te korrigoje shkeljen e KVO-se duke kualifikuar operatorin Safe sh.p.k. Per sa me siper dhe ne zbatim te L.P.P ju kerkojme:

1. Shqyrtimin dhe marrjen parasysh te ankeses tone.
2. Kualifikimin e shoqerise Safe sh.p.k.
3. Publikimin e njoftimit te ri te klasifikimit. ”.

II.4.2. Referuar ankesës së operatorit ekonomik “Safe” shpk dhe dokumentave bashkëlidhur, rezulton se me anë të shkresës shkresën nr. prot.274/1, datë 21.06.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje shoqërisë “Safe” shpk, ku ka vendosur mospranimin e ankesës; por referuar dokumentit postar të paraqitur nga ankimuesi “Safe” shpk, ky i fundit ka marrë dijëni në datë 26.06.2019.

II.4.3 Në datën 04.07.2019 operatori ekonomik “Safe” shpk ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor, duke shtuar gjithashtu dhe sa më poshtë vijon:

“se treti, Per sa I perket argumetit te KVO-se se vertetim/referenca leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Diber per llogari te shoqerise Safe nuk ka informacion per vitin 2018 per masat administrative ngjarjet etj, per te qene koherent me K.P.P bashkangjitur kesaj ankese, po ju dergojme nje fotokopje te ketij vertetimi ku mund te kuptohet qarte se cili eshte standarti I KVO-se ne vleresimin e operatoreve pjesemarres.

II.5. Në datën 15.07.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr.prot.1187/2 dhe nr.prot.1200/2, shkresa e autoritetit kontraktor nr.317, datë 12.07.2019, ku bashkëngjitur ndodhet dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre si dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike, në procedurën e prokurimit objekt ankimi, me arsyen se *“Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “NAZERI 2000” Sh.p.k, për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret Përgjithshme e të Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë: I. Nuk është përmbushur përcaktimi i gërmës “c” Kapaciteti teknik:/ pika 4 ku përcaktohet: CV të shoqërisë dhe stafit kryesorë përgjegjës për zbatimin e kontratës”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën 7/2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Për kapacitetin teknik”, pika 4, autoriteti kontraktor ka kërkuar:

“CV të shoqërisë dhe stafit kryesorë përgjegjës për zbatimin e kontratës”.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të mësipërm, ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

1. CV e shoqërisë “Nazeri 200” shpk, drejtuesi teknik dhe personelit që mban firmën e administratorit Alfred Zylalaj dhe vulën e shoqërisë “Nazeri 200” shpk;
2. CV e drejtuesit teknik 1.3.A Eduard Sulaj, e cila mban firmën e personit në fjalë;
3. CV e drejtuesit teknik 1.3.B Mehmet Bazaj, e cila mban firmën e personit në fjalë;

4. CV të staf “Nazeri 2000” shpk;
5. CV e stafit drejtues të shoqërisë “Nazeri 2000” shpk, e cila mban firmën e administratorit Alfred Zylalaj dhe vulën e shoqërisë “Nazeri 200” shpk.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”*. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.1.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit

III.1.5. Nga shyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka parashikuar që ofertuesi duhet të paraqesë *“CV të shoqërisë dhe stafit kryesorë përgjegjës për zbatimin e kontratës”*. Sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes në sistemin e prokurimit elektronik, konstatojmë se ky i fundit ka paraqitur:

1. CV e shoqërisë “Nazeri 200” shpk, që e ka titulluar *“CV e sh.p.s.f. “Nazeri 200” shpk, drejtuesi teknik dhe personelit”*, ku ka paraqitur të dhena mbi historikun, ligjshmërinë dhe objektivat, personelin, disponibilitetin teknik, eksperiencat e kësaj shoqërie ndër vite;
2. CV e 2 drejtuesve teknike;
3. CV e staf “Nazeri 2000” shpk, me emrat e 10 punonjëve të licencuar të kësaj shoqërie dhe një përmbledhje të shkurtër për secilin prej tyre;
4. *“CV e stafit drejtues të shoqërisë “Nazeri 2000” sh.p.k” që mban firmën e administratorit Alfred Zylalaj dhe vulën e shoqërisë “Nazeri 200” shpk, ku në formë narrative jepen të*

dhëna të përgjithshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e ruajtjes dhe sigurimit fizik nga kjo shoqëri.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Referuar ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe konkretisht kreut II të këtij ligji të titulluar “Administratorët”, neni 95 “Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet”, në pikën 3 të tij, gërma “a” dhe “b”, ndër të tjera përcaktohet se “Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të: a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme; b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare”. Ndërkohë referuar të njëjtit ligj, në nenin 96, pika 3 e tij përcaktohet se dhe tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Komisioni konstaton se ankimuesi “Nazeri 2000” shpk, nuk ka paraqitur CV të administratorit, si një nga personat më të rëndësishëm për një shoqëri tregtare - si personi në cilësinë e punëmarrësit në nivelin më të lartë hierarkik; duke mos dhënë kështu asnjë të dhënë konkrete në lidhje me kualifikimet e kryera nga administrator, apo eksperiencën në punë të tij. Komisioni thekson se, nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë fizike dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk e ka plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 7/2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Për kapacitetin teknik”, pika 4, të dokumentave standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, që përcakton se ofertuesi duhet të paraqesë “CV të shoqërisë dhe stafit kryesorë përgjegjës për zbatimin e kontratës”, pasi nuk ka paraqitur CV-në e titullarit të subjektit (administratorit).

III.1.6. K.P.P. gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor 10 pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me

intepretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.*

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” shpk nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet mbi arsyet e tjera të skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” shpk, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar gjykimit dhënë mësipër në pikën III.1, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, gjendja faktike dhe juridike e këtij operatori ekonomik do të vijojë të ngelet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

III.3. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “Nazeri 2000” shpk mbi operatorë të tjerë ekonomikë pjesmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimit, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se, referuar gjykimit të dhënë mësipër në pikën III.1, operatori ekonomik “Nazeri 2000” shpk do të vazhdojë të mbetet i skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, e për rrjedhojë nuk legjitimohet të godasë ofertat e shoqerive të tjera. Sa më sipër, Komisioni sjell në vëmendje dispozitat si vijon:

III.3.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: “*Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.*

III.3.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur.

Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (përkundrejt atij imagjinar) nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për rrjedhojë, pretendimet e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk nuk merren në shqyrtim, pasi operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Safe” shpk, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon si vijon:

III.4.1. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, operatori ekonomik ankimues “Safe” shpk, nuk ka paraqitur të gjitha pretendimet pranë autoritetit kontraktor, në lidhje me arsyet e skualifikimit. Konkretisht në ankesën drejtuar AK-së, nuk ka kundërshtuar apo ngritur pretendime mbi arsyen e dytë skualifikimit të tij si vijon “ *II. Nuk është përmbushur përcaktimi i gërmës “c” Kapaciteti teknik:/ pika 5 ku përcaktohet: “Subjekti SHPSF duhet të paraqesë vërtetim dhe performance nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Dibër në bazë të ligjit 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” 1.3 A, të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertave nëpërmjet të cilit të jepet informacion mbi: ... • Të mos ketë ngjarje dhe masa administrative gjatë vitit të fundit (2018). - Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës, pasi në Vërtetimin e paraqitur nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Dibër, nuk jepet informacion që operatori ekonomik të mos ketë patur ngjarje dhe marrë masa administrative gjatë vitit të fundit (2018)”, arsye të cilën e ka ngritur vetëm në ankesën drejtuar KPP-së.*

III.4.2. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pikën 2 dhe 7 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilin thuhet shprehimisht se:

“Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji”.

“Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkeljes, pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar, shkallët e ankimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor”. Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës.

III.4.3. Në nenin 20 “Forma dhe përmbajtja e ankesës”, pika 2, e Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.përcaktohet shprehimisht se:

“2. Ankesa duhet të përmbajë domosdoshmërisht elementet e mëposhtme:

- a) Të dhënat identifikuese të ankimuesit;
- b) Referimin për procedurën konkrete mbi të cilën paraqitet ankimi
- c) Bazën ligjore;
- d) Një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar;
- e) Shkallët e ankimit shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor, nëse ka;
- f) Dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën;
- g) Pretendimin e ankuesit për vendimin përfundimtar.

III.4.4 Në rastin konkret, referuar informacionit të autoritetit kontraktor, operatori ankimues nuk ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor të gjitha pretendimet që ka patur, duke mos ndjekur shkallën e parë të ankimit, e për rrjedhojë duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “*elementët e domosdoshëm të ankesës*”, referuar nenit 26 “Verifikimi i kushteve formale”, pikës 1, shkronja “d”, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ç’ka rrjedhimisht sjell si pasojë që ai të mos ketë përmbushur detyrimin për plotësimin e kushteve *formale* dhe ky fakt përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

III.4.5. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se, në rastin konkret, *ipso jure*, nuk mund të shprehet për themelin e ankimit të paraqitur nga ankimuesi, për sa kohë një pretendim i tij, nuk ka ndjekur shkallën e ankimit pranë autoritetit kontraktor.

III.4.6. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimiti, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit; në rastin në fjalë, ana formale e ankimit administrativ të paraqitur nga operatori ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 20 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, e për pasojë ankimi i paraqitur nga ana e operatorit ekonomik “Safe” shpk nuk merret në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk për procedurën e prokurimit “Shërbimi i Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike me roje private” – Marrëveshje Kuadër- me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara- me afat 12 muaj, me Nr. REF-24397-05-29-2019, me fond limit 2.333.333,3 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datën 10.06.2019 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Shëndetit Publik Mat”.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Safe” shpk për procedurën e prokurimit të mësipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit, në zbatim të nenit 63 të LPP-së.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1187 Protokoli; Datë 02.07.2019

Nr. 1200 Protokoli; Datë 04.07.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha